



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstva Obrazovanja Nauke i  
Tehnologije-Ministry of Education Science &Technology*

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

**UDHËZIM ADMINISTRATIV**  
**ZBATIMI I PLANIT DHE PROGRAMIT PËR ARSIMIN PROFESIONAL**  
**LËMI: TEKSTIL, PËR NIVELIN E PARË DHE TË DYTË (KL.X, XI dhe XII)**

**NUMËR: 20/2009**

**DATË:02.09.2009**

Në mbështetje të nenit, 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6.1 paragrafi (d) të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, nenit 6, 8, 11 të Ligjit mbi Arsimin dhe Aftësimin Profesional si dhe nenit 25 paragrafit 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ (më tutje UA):

**Neni 1**  
**Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është zbatimi i planit dhe programit mësimor për shkollat profesionale, nivelin e parë dhe të dytë (kl.X, XI dhe XII).

**Neni 2**  
**Planprogrami**


1. Plani dhe programi i ri për nivelin e parë dhe të dytë (kl.X, XI dhe XII) lëmi: *Tekstil, profilet: tjerrës, thurrës, vektar, konfeksioner*, i është bashkangjitur këtij Udhëzimi administrativ.

**Neni 3**  
**Zbatueshmëria**

I. Me zbatimin e planit dhe programit të nivelit të parë dhe të dytë (kl.10, 11 dhe 12) zëvendësohen planet dhe programet e deritashme të kl.X, XI dhe XII.

**Neni 4**  
**Hyrja në fuqi**

I. Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me fillimin e vitit shkollor 2009/2010



Enver Hoxhaj, ministër